



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Rruga "Abdi Toptani" ish- hotel "Drini", Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 185 Prot.

Tiranë, më 13.03.2017

**V E N D I M**  
**Nr. 48, datë 13.03.2017**

*"Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësit \*\*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017"*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të procedurës së verifikimit,

**VËREJ SE :**

Me anën e shkresës nr. 724/3 prot., datë 23.1.2017, nëpunësi \*\*\*\*\*\*, me detyrë "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Gjirokastrë, ka informuar Komisionerin se, institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Departamenti i Administratës Publike, në lidhje me: **a)** konstatimin si akt absolutisht të pavlefshëm të urdhrin të transferimit të tij, nga pozicioni i punës "Inspektor", në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë, në pozicionin e punës "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë, si dhe **b)** rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.

Ndërkohë, rezulton se, nëpërmjet shkresës nr. 6664/1 prot., datë 24.11.2016, "Lidhur me transferimin e dytë të \*\*\*\*\*", Departamenti i Administratës Publike, ka vënë në dijeni Komisionerin, për faktin se, me Urdhrin nr. 4024, datë 4.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, punonjësi në fjalë, është transferuar përkohësisht në pozicionin e punës "Inspektor", në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë.

Në përmbajtjen e kësaj shkrese, e cila i drejtohet edhe institucionit në fjalë, sqarohet se Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, e ka konstatuar këtë urdhër si akt absolutisht të pavlefshëm, me argumentin se është nxjerrë në kapërcim të kompetencave ligjore dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji. Më tej, për të rregulluar pasojat e krijuara nga ky veprim i parregullt, Departamenti i Administratës Publike, i ka kërkuar institucionit, (*Autoriteti Kombëtar i Ushqimit*) rikthimin në punë të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e mëparshëm të tij.

Menjëherë pasi mori dijeni për këtë fakt, me shkresën nr. 724/1 prot., datë 23.12.2016, "*Kërkohej informacion në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna nga DAP, për rastin e punonjësit \*\*\*\*\**", Komisioneri i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, që të informojë, në lidhje me reagimin ndaj detyrave të lëna nga Departamenti i Administratës Publike, për këtë rast.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ka dërguar shkresën nr. 5515/1 prot., datë 4.1.2017, "*Kthim përgjigje referuar shkresës nr. 724/1 prot., datë 23.12.2016 në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna nga DAP, për rastin e punonjësit \*\*\*\*\**", e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 724/2 prot., datë 6.1.2017, nga analiza e së cilës, rezulton se ai e vlerëson si të rregullt veprimin e tij, duke parashtruar këto argumenta:

- ✓ Në lidhje me urdhrin e transferimit të përkohshëm të punonjësit \*\*\*\*\* , pretendohet se akti administrativ ka dalë nga titullari i institucionit, për nevoja të institucionit, në drejtim të përmbushjes së objektivave që mbart AKU, në kuadër të garantimit të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.
- ✓ Në këtë rast, është vepruar në bazë të kompetencave të përcaktuara në Vendimin nr. 1081, datë 21.10.2009, të Këshillit të Ministrave, "*Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit*", i ndryshuar, sipas të cilit, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, nxjerr akte të brendshme të detyrueshme për menaxhimin administrativ, financiar, si dhe për punonjësit e AKU-së, për realizimin e funksioneve të institucionit.
- ✓ Si bazë ligjore është referuar neni 13, i ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", ku parashikohet se Kryeinspektori, është përgjegjës për organizimin e koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë e efektivitetin e veprimtarisë së inspektoratit.
- ✓ Nga ana e institucionit, në këtë rast pretendohet se urdhri në fjalë, është hartuar në funksion të rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të përmbushjes së objektivave të Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Gjirokastrë, duke ruajtur të gjitha të drejtat e nëpunësit.

Duke u nisur nga sa u analizua më sipër, Komisioneri gjatë këtij hetimi administrativ, ka marrë parasysh faktin se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, është një institucion në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil, e për këtë arsye, përfshihet në fushën e kompetencave të tij.

Nga ana tjetër, konstatohet se edhe nëpunësi \*\*\*\*\* , e gëzon statusin e nëpunësit civil, në kushtet kur ai ka filluar marrëdhënien e punës, me aktin administrativ nr. 807, datë 26.2.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, në pozicionin "*Inspektor*", në Sektorin e Kontrollit, në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, e ka gjetur punonjësin në këtë pozicion pune, për një periudhë më pak se një vit, prandaj, njësia përgjegjëse (DAP), me aktin nr. 2138/2, datë 15.8.2014, e ka deklaruar si “nëpunës civil në periudhë prove”.

Në përfundim të periudhës një vjeçare të provës, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të AKU, në Qarkun Gjirokastrë, në cilësinë e eprorit direkt, me aktin administrativ nr. 3, datë 25.5.2015, ka vendosur konfirmimin e këtij punonjësi, si “nëpunës civil”, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë.

Sipas nenit 4, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, është njësia përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, ku në rastin konkret, bën pjesë edhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Në lidhje me institutin e transferimit, sipas nenit 48, pika 1/a dhe pika 2/a, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i cili është rregulluar në mënyrë të hollësishme në Vendimin nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, në Kreun I, pika 2 të tij, përcaktohet se, “Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale...”

a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve.”

Më tej, në pikat 4 dhe 5, të po kësaj dispozite, përcaktohet se,

- ✓ “Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar apo njësisë së burimeve njerëzore;
- ✓ Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila, njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet”.

Në këto rrethana, për të realizuar një procedurë transferimi të përkohshme, për nevoja të institucionit, apo në raste të tjera, të parashikuara nga ligji, duhen respektuar kërkesat e përcaktuara në këtë dispozitë, si dhe rregullimet specifike të aktit nënligjor, që rregullon procedurat në lidhje me këtë institut të ligjit.

Në rastin konkret, Departamentit të Administratës Publike, duhet t’i dërgohet një kërkesë e motivuar nga titullari i institucionit, ose nga njësia e burimeve njerëzore, e cila, në kuptim të ligjit, duhet të miratohet nga DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse. Në një rast të tillë, Departamenti i Administratës Publike, ka detyrën e ruajtjes dhe garantimit të të drejtave të nëpunësit civil dhe detyrimeve të punëdhënësit, të tilla si distanca, afati etj.

Argumenti i parashtruar nga institucioni, se në bazë të Vendimit nr. 1081, datë 21.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, nxjerr akte të brendshme, të detyrueshme për menaxhimin administrativ, financiar, si dhe për punonjësit e AKU-së, për realizimin e funksioneve të institucionit, nuk mund të pranohet, pasi ai është i bazuar në një dispozitë

materiale e procedurale të mëparshme, të pa harmonizuar me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil, pas përfshirjes së institucionit në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë mënyrë, Komisioneri sjell në vëmendjen e Departamentit të Administratës Publike, në kuadrin e detyrave që i ka caktuar neni 7, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, që të veprojë menjëherë, për të përditësuar legjislacionin që rregullon administrimin e burimeve njerëzore në institucionin të cilin po analizojmë, e po kështu edhe në të gjitha rastet e tjera që ndodhen në të njëjtat kushte, me legjislacionin e shërbimit civil.

Sa më sipër, nisur nga gjithë informacioni i ardhur pranë Komisionerit dhe nga analiza e materialeve të administruara gjatë këtij hetimi administrativ, rezulton se, Urdhri nr. 4024, datë 4.10.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, i cili ka dalë pa marrë më parë miratimin e Departamentit të Administratës Publike, është një akt i pavlefshëm për shkak se ka dalë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, si dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, e në këto kushte, bazuar në germen “a/ii”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ai është akt administrativ, i cili sipas nenit 110 të ligjit në fjalë, nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike.

Në këto kushte, si dhe duke marrë parasysh përmbajtjen e shkresës nr. 6664/1 prot., datë 24.11.2016, të Departamentit të Administratës Publike, nëpërmjet të cilës është kërkuar marrja e masave përkatëse nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për rregullimin e pasojave të krijuara nga ky akt administrativ absolutisht i pavlefshëm dhe rikthimi i punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e mëparshëm, në bazë të neneve 110, pika 2, 111 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik që ka nxjerrë aktin e transferimit (Urdhri nr. 4024, datë 4.10.2016) pra, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, është i detyruar të anulojë këtë akt dhe të urdhërojë kthimin e nëpunësit në fjalë në vendin e punës. Vetëm pas këtij veprimi, mund të rinisë procedura, duke respektuar rregullat që u përmendën në pjesën e mësipërme të këtij vendimi.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, që të zbatojë detyrat e lëna nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet aktit administrativ nr.6664/1 prot., datë 24.11.2016, duke vepruar në këtë mënyrë:
  - Të anulohet urdhri nr. 4024, datë 4.10.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, për transferimin e përkohshëm të punonjësit \*\*\*\*\* nga pozicioni i punës, “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Gjirokastrë, në pozicionin e punës, “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit, pranë kësaj drejtorie, si akt absolutisht i

pavlefshëm, pasi ka dalë në kapërcim të kompetencave ligjore dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji.

- Të rregullohen pasojat e krijuara nga ky akt administrativ, në dëm të nëpunësit civil \*\*\*\*\* , duke e rikthyer atë në pozicionin e tij të mëparshëm të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
  3. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **15** ditë.
  4. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
  5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**